

Mandati dhe struktura e AKP-së

Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) është themeluar¹ si Agjenci e pavarur për të zgjidhur kërkesat që kanë të bëjnë me çështjet pronësore dhe të drejtën e shfrytëzimit, në respekt të pronës së patundshme private përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale që rrjedhin nga periudha kohore 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999.



Agjencia përbëhet nga tri organe, përkatësisht nga Sekretaria Ekzekutive, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) dhe Bordi Mbikëqyrës. Përveç kësaj, përmes zyrave të saj regjionale AKP-ja është e pranishme në pesë regjione të Kosovës si dhe ka zyrat e saj në Podgoricë dhe Shkup. Veprimtaria e AKP-së në Beograd, Nish dhe Kragujevc ndërmerret nga Zyrat Pronësore të Komisarariatit të Lartë për

Refugjatë të Kombeve të Bashkuara (UNHCR-së) të cilat janë themeluar përmes një Memorandumi të Mirëkuptimit në mes AKP-së dhe UNHCR-së në Prishtinë.

Zgjidhja e kërkesave

Për kërkesat e parashtruara vendimi merret nga Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) që është organ vendimmarrës quasi-judicial brenda AKP-së. KKPK-ja përbëhet nga dy Komisionerë ndërkombëtarë dhe një Komisioner vendor. KKPK-ja mban seancë çdo dy muaj ku merr vendim për të zgjidhur kërkesat të cilat i paraqiten. Vendimet e KKPK-së janë ligjërish të detyrueshme dhe i nënshtrohen të drejtës për ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës ku është caktuar paneli i përbërë nga dy gjyqtarë ndërkombëtarë dhe një gjyqtar vendor për shqyrtimin e ankesave.

¹ Për më shumë informata rreth kornizës ligjore të AKP-së, luteni t'i referoheni linkut vijues: <http://www.kpaonline.org/about.asp>

Procesi i kërkesave të AKP-së

Pranimi i kërkesave ka përfunduar më 3 dhjetor 2007, ku AKP-ja kishte pranuar 38,335 kërkesa. Pas konsolidimit dhe ndarjes së kërkesave të pranuar AKP-ja aktualisht ka gjithsej 41,152 kërkesa të regjistruara. Pas procesit të pranimit të kërkesave, AKP-ja siguroi që përmes kontrollit kualitativ të formularit të pranimit të kërkesës dhe të dokumentacionit mbështetës kishte informacion të mjaftueshëm për përpunimin e kërkesës. Nga paraqitësit e kërkesave është kërkuar informacioni shtesë në rastet kur konstatohej se është sjellë informacioni joadekuat apo ka munguar dokumentacioni mbështetës.

Më pas është ndërmarrë notifikimi fizik i pronës së kërkuar (një proces që ende vazhdon) duke vendosur njoftimet në vet pronën. Ngjashëm është bërë publikimi i të gjitha kërkesave në Gazetën e AKP-së. Të dy këto procese shërbejnë për të lajmëruar secilin që mund të ketë interes ligjor potencial në pronën për të cilën është dorëzuar kërkesë në AKP. Çdo person që ka interes ligjor në cilëndo nga pronat e kërkuara duhet të kontaktojë zyrën e AKP-së në mënyrë që të regjistrohet si palë përgjegjëse në kërkesë. Pala përgjegjëse mund të paraqitet në AKP dhe të përfshihet në proces në çdo kohë deri në datën kur KKPK-ja të merr vendimin për kërkesën.

Dokumentacioni mbështetës i parashtruar në lidhje me një kërkesë, dhe në rast të ndonjë kërkesë kontestuese, dokumentacioni shtesë i parashtruar nga pala përgjegjëse verifikohen për vërtetësi në informatat dhe arkivat publike që mund të shfrytëzohen lirisht. Në kërkesat e jokontestuese pasi të bëhet verifikimi i dokumenteve, kërkesa përgatitet për t'u paraqitur në KKPK i cili do të vendosë për kërkesën. Në kërkesat kontestuese para se të bëhet paraqitja e këtyre kërkesave në KKPK, bëhet shkëmbimi i dokumentacionit ndërmjet paraqitësit të kërkesës dhe palës përgjegjëse, të cilëve iu jepet mundësia që me shkrim të kundërshtojnë pohimet e palëve tjera për pronën. Pas shkëmbimit të dokumenteve kërkesat përgatiten dhe i paraqiten KKPK-së për vendimmarrje. KKPK-ja vendos për kërkesat në seancë të mbyllur në bazë të dokumenteve dhe informatave tjera të parashtruara. Nëse KKPK-ja vendos mund të ketë seanca dëgjimore me palët e përfshira, nëse edhe palët pajtohen.

Nëse nuk paraqitet asnjë ankesë, vendimet e KKPK-së do të jenë të zbatueshme pesëmbëdhjetë ditë pas datës së njoftimit të palëve për vendimin. Aktgjykimet e Gjykatës Supreme do të jenë të ekzekutueshme, pesëmbëdhjetë ditë pas datës së njoftimit të palëve për aktgjykimin.

Procesi pasi të jetë marrë vendimi për kërkesën

Paraqitësit e kërkesave, dhe në raste të kërkesave kontestuese palët përgjegjëse, dhe në rastet kur pala e tretë është gjetur në pronë gjatë kohës së notifikimit fizik do të kontaktohen me telefon nga një punonjës i AKP-së për të caktuar datën e tërheqjes së vendimit në cilëndo nga Zyrat e AKP-së apo Zyrat Pronësore të UNHCR-së.

Nëse një person dështon të tërheq vendimin në datën e caktuar për dorëzimin e vendimit, vendimi përfshihet në listën e vendimeve që



nuk janë tërhequr e cila publikohet për 30 ditë në Zyrën e AKP-së ose në Zyrën Pronësore të UNHCR-së, të cilën ky person e ka zgjedhur për të tërhequr vendimin. Nëse vendimi nuk tërhiqet atëherë konsiderohet se pala është njoftuar me vendimin 45 ditë pas datës së caktuar për tërheqje.

Si të parashtrohet ankesa nëse palët nuk pajtohen me vendimin?

Nëse palët nuk pajtohen me vendimin e KKPK -së apo me ndonjë pjesë të vendimit ato kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së brenda 30 ditësh pas njoftimit për vendimin. Ankesa duhet të parashtrohet me shkrim, përmes një letre të dorëzuar personalisht apo me postë, faks apo postë elektronike (email), së bashku me një kopje të letërnjoftimit. Ankesa duhet të parashtrohet brenda afatit prej 30 ditësh në cilëndo nga zyrat e AKP-së apo në Zyrën Pronësore të UNHCR-së. Udhëzime dhe informata tjera më të hollësishme për procesin e ankesave ofrohen në një faqe të veçantë e cila i bashkëngjitet secilit vendim. Në rast të ndonjë ankesë zbatimi i vendimit të KKPK-së pezullohet deri në kohën kur Gjykata Supreme nxerr aktgjykimin e vet për ankesën.

Zbatimi i vendimeve përfundimtare

Qëllimi i fazës së zbatimit është që vendimet e KKPK-së dhe aktgjykimet e Gjykatës Supreme të hyjnë në fuqi; të mbrohen të drejtat e të gjitha palëve në procedurë; të shfrytëzohen burimet në dispozicion në mënyrë të drejtë, efektive dhe të administruar lehtë duke siguruar sundimin e ligjit në të njëjtën kohë. Gjykata Supreme dhe/apo KKPK-ja gjatë vendimmarrjes mbi kërkesën do të parashkruajë ndihmën ligjore për ekzekutimin e vendimit, kjo mund të përfshijë, por nuk është e kufizuar, në dëbimin, vënien e pronës nën administrim, marrëveshjen për qiradhënien, konfiskimin apo rrëzimin e objekteve të paligjshme dhe ankandin.

Për të zbatuar një vendim paraqitësi i suksesshëm i kërkesës duhet të këshillojë AKP-në për mënyrën se si dëshiron që vendimi të zbatohet. Në respekt të kësaj, vendimit të KKPK-së apo aktgjykimet të Gjykatës Supreme i bashkëngjiten shënime të cilat ofrojnë sqarime të hollësishme lidhur me tri metodat kryesore që paraqitësit e kërkesave mund t'i shfrytëzojnë, përkatësisht: riposedimi, vënia e pronës nën administrim me ose pa përfshirje në skemën vullnetare të qiradhënies apo kërkesa për mbylljen e lëndës. Në rastet kur parashkruhen mjetet tjera ligjore do të jepen shënime të veçanta sqaruese në bazë të mjetit ligjor të dhënë dhe të vet kërkesës.

Llojet e pronave të cilat AKP-ja mund t'i administrojë me kërkesë të paraqitësve të suksesshëm të kërkesave janë: pronat banesore, bujqësore dhe komerciale. AKP-ja nuk mund t'i administrojë pronat në vijim: (i) pronat që kanë nevojë për miratimin e bashkëpronarëve tjerë dhe miratimi nuk është dhënë; (ii) pronat që sipas raportit të vlerësimit profesional të AKP-së nuk janë të përshtatshme për t'i vënë nën administrim të AKP-së dhe (iii) pyjet.

Kërkesat e pranuar dhe të vendosura në tërësi dhe sipas regjioneve deri në prill të vitit 2011

	Kërkesat e pranuar	Kërkesat e vendosura
Në tërë Kosovën	41152	13053
MITROVICË	4498	1454
GJILAN	8930	3162
PEJË	14183	3032
PRISHTINË	7039	2627
PRIZREN	6502	2778

FLETË INFORMUESE

HOLLËSITË KONTAKTUESE TË AKP-SË

Zyra Qendrore e AKP-së:
Perandori Justinian, nr. 5
Gyteza Pejton
10 000, Prishtinë
Telefoni: +381 (0)38 249-918; Telefaksi: + 381 (0) 38 249 919

Zyrat Regjionale të AKP-së:

Zyra Regjionale në Gjiilan
Rr.Lidhja e Prizrenit nr. 114
60 000, Gjiilan
Telefoni: 0280 320 289; Telefaksi: 0280 324 067

Zyra Regjionale në Mitrovicë
Zyra kryesore:
Selia regjionale e UNMIK-ut (ish- Jugobanka)
40 000, Mitrovicë
Telefoni: + 381 (0) 28 530 136/7; Telefaksi: +381 (0) 28 530 139
Zyra për palë:
Jug: Rr.Mbretëresha Teuta, (përballë ish -Jugobankës)
Veri: Filip Vishnitiq pn
Ndërtesa TREPÇA kati i 2-të, zyra nr. 18

Zyra Regjionale në Pejë
Rr.Mbretëresha Teuta, nr. 85
30 000, Pejë
Telefoni: +381 (0) 39 431 668; Telefaksi: +381 (0) 39 432 970

Zyra Regjionale në Prishtinë
Zyra kryesore:
Rr.Rexhep Luci (ish- Goleshka) nr. 2
10 000 Prishtinë
Telefoni: +381 (0) 38 225 473; Telefaksi: +381 (0) 38 244 854
Zyra për palë:
Rruga kryesore, nga Prishtina në Gjiilan, 50 m pas urës në anën e djathtë të rrugës.
Graçanicë

Zyra Regjionale në Prizren
Rr. Wiliam Walker pn (në bazën e EULEX-it)
20 000, Prizren
Telefoni: +381 (0) 29 231 469
+381 (0) 29 231 429

Shtypi i kësaj fletëpalosje është mbështetur nga OSBE Misioni në Kosovë

Zyrat e AKP-së në teren

Zyra në teren në Podgoricë
Rr. Crnogorskih Serdara
81 000, Podgoricë
Telefoni: +382 (0) 20 624 216
Orari i punës: 08:00 – 16:00

Zyra në teren në Shkup
Rr.Vihniqa nr. 10
(ndërtesa-CDRIM), kati i parë
1000, Shkup
Telefoni: +389 (0) 71 886 564
Orari i punës: 08:30 – 17:00

Zyrat pronësore të UNHCR-së:
UNHCR-ja ka themeluar tri zyra pronësore për t'i ofruar ndihmë çdo personi, i cili ka parashtruar kërkesë Agjencisë Kosovare të Pronës e të cilat mund të kontaktohen në këto adresa:

Beograd
Rr.Vishegradska nr. 23
11 000, Beograd
Telefoni: 011/362-13-93; 362-13-94
Telefaksi: 011/361-27-48

Nish
Rr.Dushanov Bazar (Piramida) kati i 2-të,
Zyra nr.. 216
18 000, Nish
Telefoni: 018 203-777

Kragujevc
Rr. Lole Ribara, nr. 9, kati i 1-rë
34 000, Kragujevc
Telefoni: 034 330-234;
Telefaksi: 034 335-244

FLETË INFORMUESE

